

ALBBAKËR SH.A. NË LIKUIDIM TIRANË

NIPT J81920006K

SHTESA PËR SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE 2020

Shenimet shpjeguese janë hartuar sipas kërkesave të nenit 16 të ligjit Nr 25/2018, datë 10.05.2018 “ Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”

Renditja e tyre është bërë sipas zerave të paraqitur në Pasqyrën e pozicionit financiar dhe Pasqyrën e performancës.

Shoqëria “ALBBAKËR” sh.a. në Likuidim është shoqëri aksionere me kapital 100 përqind shtetëror me pronar Ministrin e Financave dhe Ekonomisë.

Në shoqërinë “ALBBAKËR” sh.a. në Likuidim funksionon Këshilli Mbikqyrës i përberë nga 3 anëtarë të emëruar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Kosto e shpërblimit të anëtarëve të keshillit mbikqyrës për vitin 2020 është 739.800 lekë.

Numri i punonjësve të shoqërisë “ALBBAKËR” sh.a. në Likuidim për vitin 2020 është 20 punonjës gjithsej. Numri i punonjësve i ndarë sipas kategorive dhe kostove të punës e sigurimeve shoqërore e shëndetsore për vitin 2020 është si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Numri mesatar	Kosto e pagave gjithsej (lekë)	Kosto e sigurimeve (lekë)
1	Drejtues (Likuidator)	1	1 122 000	187.374
2.	Specialistë me arsim të lartë	7	5.757.000	961.419
3.	Teknikë e specialist në zbatim	0	0	0
4	Nëpunës të thjeshtë	2	1.440.000	240.480
5	Punëtorë	10	6.000.000	1.002.018
	Shuma gjithsej	20	14.319.000	2.391.291

Shoqëria “ Albbakër “ sh.a në likuidim Tiranë me NIPT J81920006K, ka qendrën e veprimtarisë në Bllokun “ Vasil Shanto” pranë Godinës se ish- KESH sh.a Tiranë.

Ndërtesa ku ushtron aktivitetin administrativ shoqëria “Albbakër” është në përgjegjësi administrimi të KESH sh.a Tiranë. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 33, dateë16.01.2008 “ Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë, Tregtisë dhe Energjetikës të mjediseve të ish-Institutit të Mjedisit dhe në përgjegjësi administrimi nga OST-shaja, Ministrisë se Drejtësisë të mjediseve të Dispeçerisë Qëndrore”.

Ndërtesa është njëkatëshe. Në këtë ndërtesë kemi 5 zyra të vogla me sipërfaqe 94 m².

Në këtë ndërtesë ushtron aktivitetin e saj edhe shoqëria “Albkrom “ sh.a Tiranë.

Shoqëria “Albbakër” ka në pronësi shumë objekte ndërtimore të cilat ndodhen në vendburimet e mineralit të bakrit në rrethet Has, Pukë, Shkodër, Mirditë, Kurbin dhe Korçë, të cilat janë në proces privatizimi.

Të gjitha objektet ndërtimore apo siperfaqet funksionale të objekteve që administrohen nga shoqëria janë të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 336, datë 01.06.2004 “ Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi “Albbakër” sh.a-së Tiranë” të ndryshuar. Për shumicën e siperfaqeve të këtyre objekteve është marrë edhe vërtetimi hipotekor nga ZVRPP të rretheve përkatëse.

Shoqëria “Albbakër” sh.a Tiranë nuk ushtron aktivitet prodhimi, pasi që në vitin 2004 ka kaluar në likuidim. Shoqëria po zbaton procedurat ligjore për shitjen e asetëve të saj dhe mbylljen e bilancit të likuidimit,

Për të kontrolluar dhe çertifikuar llogaritë vjetore të shoqërisë “ALBBAKËR” që mbyllen më 31.12.2020, nga ana e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë me shkresën Nr. 2792, date 10.02.2021 “ Mbi caktimin e Audituesve ligjore për certifikim bilanci” janë caktuar si auditues ligjor 2 shoqëri audituese me ekspertë kontabël të regjistruar .

Auditimi i Pasqyrave Financiare të vitit 2020 është në proces nga ana e eksperteve ligjore.

Gjatë vitit 2020 me kërkesë të shoqërisë është miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë një procedurë vlerësimi me ekspertë të fushës dhe konkretisht:

- Me Urdhërin Nr 401, datë 27.11.2019 “ Për përgatitjen e dokumentacionit të zvogëlimit të kapitalit themeltar të shoqërisë “Albbakër” sh.a. në Likuidim për objektet e ish-Burgut Spaç me tarifën 300.000 lekë (treqindmijë), pa TVSH.

Raporti i ekspertit të caktuar është miratuar me Vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve Nr 156, datë 23.06.2020 “ Për të zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë “Albbakër” sh.a. në Likuidim”

Sqarojmë se vlerat e këtyre tarifave të përcaktuara në kontrata janë pasqyruar në Pasqyrën e performancës,.

Shërbimi nga këto subjekte është kryer dhe janë miratuar edhe nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Për drejtimin e Njesisë Ekonomike

Petraq PREMTI

